



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova -Republic of Kosovo**

*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**Projektligji për Peticione**

## **KREU I**

### **Të përgjithshme**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është të rregullojë të drejtën e peticionit, mënyrën dhe kushtet e paraqitjes së peticionit, përgjegjësitë e Kuvendit dhe institucioneve tjera gjatë procedurës së shqyrtimit të peticionit, llojet e vendimeve dhe çështjen e bashkëpunimit të institucioneve të ndryshme me Kuvendin.

#### **Neni 2**

Ky ligj zbatohet vetëm për peticione dhe nuk zbatohet për të drejtat tjera të qytetarëve për t'iu drejtuar me kërkesa dhe ankesa institucioneve shtetërore.

#### **Neni 3**

#### **Përkufizimet**

**Ankesë** - në kuptim të këtij ligji do të thotë kundërshtimi i një veprimi apo mosveprimi të institucioneve shtetërore, agjencive të pavarura apo institucioneve tjera që kryejnë detyra publike.

**Komisioni** - komisioni i veçantë për peticione ose komisioni përkatës i Kuvendit që ka në fushëveprimtarinë e vet shqyrtimin e peticioneve

**Kërkesë** - në kuptim të këtij ligji do të thotë propozimi për një veprim ose mosveprim të institucioneve shtetërore, agjencive të pavarura apo institucioneve tjera që kryejnë detyra publike.

**Objekt i petitionit** - kërkesa dhe ankesa për të cilën kërkohet të vendoset në Kuvend

**Petent** – personi që përmes petitionit i drejtohet Kuvendit për të trajtuar një çështje të caktuar

**Peticion** – e drejta themelore e personave fizikë dhe juridikë për t'iu drejtuar Kuvendit me kërkesë dhe ankesë në emër të vetes, për personat e tretë apo e përgjithshme.

## **KREU II**

### **Peticioni dhe Petenti**

#### **Neni 4**

##### **E drejta e petitioni**

1. Të drejtën për t'iu drejtuar Kuvendit me petition gëzon çdo person, pavarësisht nënshtetësisë, por që ka vendbanimin apo vendqëndrimin në territorin e Republikës së Kosovës.
2. E drejta e shërbyesve civil për të shfrytëzuar të drejtën e petitionit nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi. Shfrytëzimi i kësaj të drejte i drejtohet drejtpërdrejtë Kuvendit dhe nuk ka nevojë të ndjekë rrugët zyrtare.
3. E drejta për t'ju drejtuar institucioneve shtetërore në mënyra të tjera të paraparë me ligj, nuk kufizohet me këtë ligj.
4. Nismat legislative nga qytetarët rregullohen me ligj të veçantë.

#### **Neni 5**

##### **Llojet e peticioneve**

1. *Peticione të njëjta* janë peticione që kanë të njëjtin objekt të petitionit, por që janë dërguar individualisht nga petentët.
2. *Peticione kolektive* janë peticione me të njëjtin objekt të petitionit dhe të nënshkruar kolektivisht nga petentët.
3. *Peticione masive* janë një numër peticionesh të ndryshme me të njëjtin objekt të petitionit, teksti i të cilave është pjesërisht apo tërësisht i njëjtë.

4. Peticion në kuptim të këtij ligji nuk janë kërkesat për informacion si dhe njoftimet, mirënjohjet, deklaratat apo çfarëdo shprehje mendimi, që në vete nuk ka një kërkesë për veprim apo mosveprim të institucioneve shtetërore.

## **Neni 6**

### **Petenti**

1. Petent mund të jetë çdo person pavarësisht nënshtetësisë së tij, por që ka vendbanimin apo vendqëndrimin në Republikën e Kosovës.

2. Pazotësia e veprimit apo mungesa e moshës madhore nuk e pengojnë të drejtën për ushtrimin e pavarur të së drejtës së petitionit. Është e mjaftueshme që petenti pa zotësi të veprimit apo moshës jo-madhore të shprehë qartë kërkesën apo ankesën e tij.

3. Personat juridikë të së drejtës private gëzojnë të drejtën e paraqitjes së petitionit. Personat Juridikë të së drejtës publike po ashtu gëzojnë të drejtën e paraqitje së peticioneve, por vetëm brenda fushës së veprimtarisë së tyre.

## **Neni 7**

### **Ndalimi i diskriminimit**

1. Ndalohet çdo lloj i diskriminimit ndaj petentëve për arsye të ushtrimit të së drejtës së petitionit.

2. Ndalohet diskriminimi apo ushtrimi i masave disiplinore ndaj të punësuarve në shërbimin civil apo institucionet tjera shtetërore dhe agjenci të pavarura për arsye të ushtrimit të së drejtës së petitionit.

## **Neni 8**

### **Objekt i petitionit**

1. Objekt i petitionit është kërkesa dhe ankesa.

2. Procedurat gjyqësore dhe vendimet gjyqësore nuk mund të jenë objekt i petitionit.

3. Marrëdhëniet e së drejtës private të qytetarëve dhe personave juridikë të së drejtës private nuk mund të jenë objekt i petitionit.

## **Neni 9**

### **Peticioni në raste të veçanta**

1. Peticionet e të paraburgosurve dhe të burgosurve si dhe çdo personi tjetër i cili është privuar nga liria nga ndonjë institucion i sigurisë apo drejtësisë, duhet t'i dërgohen Kuvendit, të mbyllura dhe pa u kontrolluar nga institucioni ku mbahet petenti.

2. Personave nga paragrafi 1 i këtij neni mund t`u ndalohet peticioni kolektiv dhe masiv, kur komunikimi ndërmjet tyre apo personave të tjerë është i ndaluar me ligj apo vendim gjyqësor. Peticioni kolektiv dhe masiv mund të ndalohet, kur përgatitja dhe përpilimi i përbashkët i peticionit do të rrezikonte sigurinë dhe rendin e institucionit ku ata mbahen.

3. Peticionet që për petent kanë një person nga paragrafi 1 i këtij neni apo që për objekt të peticionit ka të drejtën e azilit, trajtohen me prioritet dhe në kohën më të shpejtë nga Kuvendi.

### **Neni 10**

#### **Forma dhe përmbajtja e peticionit**

1. Peticioni duhet të dorëzohet në formë të shkruar dhe të nënshkruar nga petenti. Nga petenti kërkohen të dhënat personale (ditëlindja, adresa e vendbanimit dhe numri personal) si dhe objekti i peticionit.

2. Në rast se peticioni dorëzohet nga një përfaqësues, përveç të dhënave të kërkuara në paragrafin 1 të këtij neni, kërkohet edhe autorizimi i nënshkruar nga përfaqësuesi. Petenti në emrin e të cilit është dorëzuar peticioni, mund të revokojë në çdo kohë autorizimin dhe të tërheqë peticionin.

3. Peticioni mund të dorëzohet edhe përmes formës elektronike (Peticioni elektronik). Për këtë qëllim, Kuvendi do të kujdesët që gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të mundësojë ushtrimin e së drejtës së peticionit përmes formë elektronike. Në këtë rast, nënshkrimi në peticionin elektronik zëvendësohet përmes të dhënave personale të kërkuar në paragrafin 1 të këtij neni.

4. Peticioni elektronik mund të organizohet edhe nga vetë petentët. Në këtë rast, duhet të plotësohen kushtet formale nga paragrafi 1 i këtij neni. Nënshkrimi zëvendësohet sipas paragrafit 3 të këtij neni.

5. Peticioni që i dorëzohet Kuvendit dhe nuk i plotëson kushtet e këtij neni, Komisioni i`a kthen atë petentit për plotësimin e kushteve formale brenda një afati të caktuar. Peticionet e dorëzuara pas afatit të përcaktuar nga Komisioni, shqyrtohen sikur të jenë dorëzuar për herë të parë.

### **Kreu III**

#### **Bashkëpunimi**

##### **Neni 11**

#### **Detyrimi për bashkëpunim**

1. Gjatë përgatitjes së vendimeve lidhur me peticionin, institucionet e administratës dhe të gjitha institucionet e tjera shtetërore, përfshirë edhe agjencitë e pavarura, gjykatat dhe prokurorinë e shtetit, janë të obliguara të bashkëpunojnë me Komisionin.

2. Bashkëpunimi përfshin ndër të tjera:

2.1. qasje në dokumentet zyrtare;

2.2. dhënien e informacioneve nga fushëveprimtaria e institucionit;

2.3. qasje në objektin e institucionit me dhe pa paralajmërim.

3. Të gjitha institucionet shtetërore janë të obliguara që kërkesat e Komisionit t'i shqyrtojnë me prioritet dhe kërkesës së Komisionit t'i përgjigjen brenda afatit prej gjashtë javësh pas marrjes së kërkesës. Afati i përgjigjes mund të zgjatet me aprovimin e Komisionit.

## **Neni 12**

### **Ftesa për dëgjim**

1. Komisioni, me qëllim të kryerjes së detyrave të tij, mund të ftojë për dëgjim petentë, dëshmitarë dhe ekspertë.

2. Komisioni mund të ftojë edhe të punësuar nga paragrafi 1 i nenit 11, për t'i dëgjuar lidhur me objektin e peticionit.

3. Komisioni bën kompensimin e të gjitha shpenzimeve që u shkaktohen të ftuarve për ardhjen e tyre. Gjatë kohës së qëndrimit para komisionit, të punësuarit janë të liruar nga angazhimet e tyre dhe nuk mund të dënohen për mosprezencën në vendin e punës.

## **Neni 13**

### **Refuzimi i bashkëpunimit**

1. Bashkëpunimi nga neni 11 dhe 12 mund të refuzohet kur zbulimi i informacionit apo qasja në objektin e institucionit i nënshtrohet fshehtësisë në bazë të ligjit, apo për arsye tjera thelbësore fshehtësinë e bëjnë të domosdoshme.

2. Bashkëpunimi nga neni 11 dhe 12 mund të refuzohet kur ai paraqet rrezik për sigurinë dhe rendin e institucionit apo zbulonte një fshehtësi zbulimi i së cilës do të shkaktohte dëme të pariparueshme për institucionin.

3. Lidhur me refuzimin e bashkëpunimit vendos autoriteti më i lartë kompetent i institucionit. Vendimi për refuzim duhet të arsyetohet dhe të bazohet në ligj.

4. Kur Komisioni vlerëson se arsyetimi është i pabazuar, paqëndrueshëm apo i pamjaftueshëm, mund të kërkojë raportimin e autoritetit pranë Komisionit për arsyet e refuzimit.

5. Kur të ftuarit nga paragrafi 1 i këtij neni refuzojnë ftesën për dëgjim, Komisioni mund të kërkojë nga gjykata kompetente dënimin sipas ligjit në fuqi.

## **Kreu IV**

### **Komisioni dhe procedura e shqyrtimit**

#### **Neni 14**

##### **Komisioni për peticione**

1. Me qëllim të shqyrtimit të peticioneve, Kuvendi krijon Komisionin Parlamentar për Peticione.
2. Komisioni mund të ekzistojë si komision i veçantë apo si nënkomision i një komisioni kryesor. Organizimi dhe përbërja e këtij Komisioni rregullohet sipas Rregullores së Kuvendit.
3. Përveç kur është parashikuar ndryshe me këtë ligj, Komisioni zbaton rregulloren e Kuvendit.

#### **15 Neni**

##### **Mbledhjet e Komisionit**

1. Mbledhjet e Komisionit janë të hapura.
2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, mbledhjet mund të jenë të mbyllura kur shqyrtimi i peticionit rrezikon përhapjen e informacioneve që vlerësohen si fshehtësi ose kur do të rrezikohej siguria publike.

#### **Neni 16**

##### **Bartja e detyrave**

Me qëllim të rritjes së efikasitetit gjatë shqyrtimit të peticioneve, Komisioni mund të autorizojë që disa ose të gjitha veprimet e nevojshme deri në marrjen e vendimit, t'ia bartë një apo më shumë anëtarëve të Komisionit. Vendimi merret në mbledhje të Komisionit.

#### **Neni 17**

##### **Kompetencat e Komisionit**

1. Komisioni shqyrton peticionet që prekin fushëveprimtarinë e Kuvendit të Kosovës.
2. Komisioni shqyrton peticionet që prekin fushëveprimtarinë e administratës shtetërore, agjencive të pavarura dhe institucioneve të tjera shtetërore.
3. Komisioni shqyrton peticionet që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave të qytetarëve nga cildo institucion, agjension, organizatë.

#### **Neni 18**

##### **Detyrimi për shqyrtim**

1. Komisioni duhet të shqyrtojë çdo peticion i cili i plotëson kushtet sipas nenit 10 të këtij ligji.
2. Komisioni mund të refuzojë shqyrtimin e një peticioni, kur petenti ka dorëzuar më herët peticion me objekt të njëjtë, por jo më larg se 1 vit.
3. Secili peticion, në parim mund të shqyrtohet edhe në seancë plenare të Kuvendit. Për këtë vendos Komisioni.
4. Kur peticioni është nënshkruar nga së paku 20 mijë petentë, apo kur bëhet fjalë për peticion masiv nënshkrimi i të cilave arrin numrin prej 20 mijë petentë, Kuvendi është i obliguar që të shqyrtojë peticionin edhe në seancë plenare.
5. Komisionit i ndalohet të ndërhyjë në kërkesat, rekomandimet e peticionit.

## **KREU V**

### **Vendimi lidhur me peticionin**

#### **Neni 19**

#### **Vendimi**

1. Komisioni pas shqyrtimit në mbledhje vendos si vijon:
  - 1.1. Peticioni së bashku me rekomandim/e i dërgohet Kuvendit për vendim përfundimtar;
  - 1.2. Petenti udhëzohet që fillimisht të ndjekë rrugën administrative apo gjyqësore. Lidhur me këtë, Komisioni njofton petentin për rrugën që duhet ndjekur;
  - 1.3. Kur Komisioni vlerëson se një institucion tjetër do ta shqyrtonte më mirë, peticionin ia dërgon institucionit tjetër dhe për këtë njofton petentin.
  - 1.4. Komisioni e vlerëson si të papërshtatshëm për shqyrtim të mëtutjeshëm.
2. Lidhur me vendimin nga paragrafi 1 i këtij neni, Komisioni e njofton petentin brenda 10 ditësh pas marrjes së vendimit.
3. Njoftimi duhet të përmbajë arsyetimin se cilat dëshmi dhe rrethana kanë ndikuar në vendimin e marrë.
4. Kundër vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni nuk lejohet ankesa.

#### **Neni 20**

#### **Dërgimi i vendimit për zbatim**

1. Kur Kuvendi në seancë plenare aprovon peticionin, vendimi i dërgohet qeverisë apo institucionit përkatës për zbatim.
2. Qeveria apo institucionet tjera, janë të obliguara të zbatojnë vendimet e Kuvendit.

3. Kur qeveria apo institucioni përkatës refuzon të zbatojë vendimin nga Kuvendi, i njëjti brenda 4 javësh pas pranimit të vendimit duhet të njoftojë Kuvendin mbi arsyet e refuzimit të zbatimit të vendimit.

4. Kur Komisioni konstaton se arsyet e institucionit për refuzim janë të paqëndrueshme, e fton institucionin në një dëgjim publik për të raportuar për arsyet e refuzimit.

#### **Neni 21**

##### **Raporti vjetor**

Komisioni harton çdo vit një raport të detajuar mbi punën e vet. Raporti ndër të tjera duhet të përmbajë:

1. Numrin dhe llojin e peticioneve të pranuar;
2. Numrin e peticioneve të refuzuara në mungesë të plotësimit të kushteve formale;
3. Llojet e objekteve të peticioneve;
4. Numrin e peticioneve të shqyrtuara dhe numrin e peticioneve të dërguara në Kuvend për vendosje;
4. Numri i vendimeve të dërguara institucioneve tjera për zbatim dhe numri i vendimeve të zbatuara;
5. Numri i peticioneve të refuzuara për zbatim nga institucionet dhe arsyet për refuzim.

#### **Neni 22**

##### **Peticionet e papërfunduara në një legjislaturë**

Peticionet e pashqyrtuara deri në një vendim përfundimtar sipas nenit 19, barten në legjislaturën e re dhe gëzojnë përparësi në shqyrtim, sipas datës së pranimit, para peticioneve të pranuar në legjislaturën aktuale.

### **Kreu VI**

#### **Dispozitat kalimtare dhe hyrja në fuqi**

##### **Neni 23**

##### **Nxjerrja e akteve nënligjore**

Kuvendi brenda 3 muajsh pas hyrjes në fuqi të ligjit nxjerr rregullore të brendshme për shqyrtimin e peticioneve.

##### **Neni 24**

##### **Hyrja në Fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Kadri Veseli

---

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës



